



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur më datë 15.03.2022 ndërmjet:

Komunës së Lipjanit, përfaqësuar nga Kryetari i Komunës Imri Ahmeti, adresa rr.Shqipëria në Lipjan

dhe

Unionit të Turizmit të Kosovës, Adresa: Rr. Pashko Vasa nr.54, 10000 Prishtinë,
Përfaqësuar nga Baki Hoti – Kryetar i Unionit të Turizmit të Kosovës.

I.DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i Marrëveshjes

Qëllimi i kësaj marrëveshje është rritja e bashkëpunimit në mes të Komunës së Lipjanit dhe Unionit të Turizmit të Kosovës në përmirësimin e gjendjes në sektorin e Turizmit në Komunën e Lipjanit.

Neni 2

Obligimet e palëve

Palët e kësaj marrëveshjeje dakordohen në koordinimin dhe bashkëpunimin e aktiviteteve të ndërsjellta, si në hartimin e politikave, strategjive zhvillimore dhe aktiviteteve turistike.

Neni 3

Aktivitetet e Planifikuara

1. Palët dakordohen në koordinimin e aktiviteteve dhe integrimin në planet vjetore të tyre, specifikuara, në fushat e:
 - 1.1. Koordinimit të aktereve të Turizmit në Komunën e Lipjanit;
 - 1.2. Zhvillimit dhe promovimit të Turizmit të Qëndrueshëm;
 - 1.3. Përmirësimit të politikave zhvillimore në sektorin e Turizmit.
 - 1.4. Bashkëpunimi në përpilimin e materialeve promovuese të Turizmit
 - 1.5. Bashkëpunimi në përfshirjen e Lipjanit në sa më shumë paketa turistike të cilat do të përpilohen nga Touroperatorët.
 - 1.6. Mundësia e pjesëmarrjes në Panaire Ndërkombëtare të Turizmit me qëllim promovimin.
 - 1.7. Bashkëpunimi në projekte të ndryshme që nderlidhen me Turizmin në përgjithësi.

Neni 4

Koordinimi dhe konsultimi

Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin e shkëmbimit të të dhënave turistike si dhe praktikave të mira profesionale.

Pjesëmarrësit gjithashtu do të takohen periodikisht për të shqyrtuar aktivitetet në fushën e turizmit, dhe për të shkëmbyer informacione të rëndësishme. Çdo shqetësim në lidhje me interpretimin, administrimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje të Bashkëpunimit zgjidhet me anë të konsultimeve midis palëve.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

1. **Ndryshimet dhe ndërprerja e marrëveshjes.** Secila nga palët mund të ndërpresë pjesëmarrjen e saj në këtë Marrëveshje të Bashkëpunimit, duke dërguar palëve të tjera një njoftim me shkrim tridhjetë (30) ditë më parë.
2. **Data e hyrjes në fuqi dhe kohëzgjatja.** Kjo Marrëveshje e Bashkëpunimit hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga të gjitha palët, në afatë kohor prej 3 viteve me mundësi vazhdimi.
3. **Përfaqësuesit.** Palët do të përfaqësohen nga personat e mandatuar ose që veprojnë në emër të nënshkruesve të kësaj Marrëveshjeje bashkëpunimi. Secila nga palët, përmes një njoftimi me shkrim të dërguar palëve të tjera, mund të emërojë

një përfaqësues tjetër të autorizuar për të përfaqësuar atë palë në lidhje me të gjitha qëllimet që nuk kanë lidhje me ndryshimet zyrtare të kësaj Marrëveshjeje të Bashkëpunimit. Secila palë do të informojë palët e tjera, me shkrim, në lidhje me ndryshimin e përfaqësuesit të autorizuar.

4. Palët do të përpiqen të zgjidhin çdo keqkuptim ose mosmarrëveshje të mundshme në lidhje me këtë marrëveshje në mënyrë miqësore

5. Kjo marrëveshje është hartuar në tri kopje identike me të cilën secila nga palët merr një kopje të marrëveshjes.

Për Komunën e Lipjanit



Imri Ahmeti
Kryetar i Komunës

Për Unioni i Turizmit të Kosovës

A handwritten signature in blue ink, which appears to be "B. Hoti", is written over a horizontal line.

Baki Hoti
Kryetar, UTK

Lipjan
MARS 2022